



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1776/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , Udhëzimin Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funksonimin e Komiteteve Konsultative në Komuna neni 7.4, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 57. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2017 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË TRI KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2016

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së tri i Komiteteve Konsultative të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2016.

II

Duke ju referuar nenit I të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës për vitin 2016 i Komitetit Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komitetit Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetit Konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 30.03.2017

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Braya





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1775/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 , Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit 03/L-199 për Gjykatat neni 10. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2017 merr:

V E N D I M

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për inicimin e realizimit për hapjen e Gjykatës Themelore në Ferizaj, dega Hani i Elezit.

II

Zyra e kryetarit të komunës pas këtij vendimi duhet të paraqesë kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për themelimin e Gjykatës, duke ju referuar dispozitës ligjore të nenit 10 të Ligjit për Gjykatat më numër 03/L-199.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Këshilli Gjyqësorë i Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.03.2017

Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava





01/Nr. 2103 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11,12,40, Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 05/L-125 për vitin 2017 neni 9, paragrafi 1.2 dhe pika 5, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 27, Ligji i Procedurës Administrative Nr.02/L-28 neni 107, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2017 merr:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01/Nr.820/2017 PËR BARTJEN E MJETEVE TË PA SHPENZUARA NGA TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE TË VITIT 2015 DHE 2016 NË VITIN VIJUES 2017

I

Kuvendi i komunës miratoj vendimin për ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.820/2017 për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake komunale të vitit 2015 dhe 2016 në vitin vijues 2017.

II

Të hyrat e bartura nga viti 2015 në vitin 2016 kanë qenë në shumën prej 129,093.66 € dhe prej tyre janë shpenzuar në shumën prej 106,108.28 €, kurse për bartje kanë mbetur edhe 22,985.38 €. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2016 kanë qenë në shumë prej 251,831.04 €, prej tyre janë të shpenzuara 188,624.28 €, kurse për bartje janë edhe 63,206.76 €.

III

Pra, të hyrat vetanake të vitit 2015 dhe 2016 në total janë në shumën prej 86,192.14 €, të cilat i bartim për vitin 2017.

IV

Këto mjete i shpërndajmë nëpër këto programe / nën-programe buxhetore dhe kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon: mallra dhe shërbime në shumë prej 545.40 €; shpenzime komunale në shumë prej 455.58 €; subvencione dhe transfere në shumë prej 388.00 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 84,803.16 €.

V

Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime në shumë prej 545.40 €, në programet dhe nën-programet si vijon:
Shërbimet publike dhe Emergjencia (180) nën-programi Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve (18444) në nën kategorinë (13780) në shumë prej 119.22 €;
Bujqësia Pylltaria dhe Zhvillim Rural (470) nën-programi Pylltaria dhe inspeksioni (47115) në nën kategorinë (13310) në shumë prej 7.50 €; pastaj në nën kategorinë (13780) në shumë prej 79.71 €;
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730) nën-programi Shërbimet e shëndetësisë primare (75050) në nën kategorinë (13470) në shumë prej 110.00 €; pastaj në nën kategorinë (14010) në shumë prej 169.19 €;
Arsimi dhe shkenca (920) nën-programi Administrata (92175) në nën kategorinë (13780) në shumë prej 59.78 €.

VI

Në kategorinë ekonomike **Shpenzime komunale** në shumë prej **455.58 €**, në programet dhe nën-programet si vijon: Administrata dhe Personeli (163) nën-programi Administrata (16335) në nën kategorinë (13230) në shumë prej 455.58 €;

VII

Në kategorinë ekonomike **Subvencione dhe transfere** në shumë prej **388.00 €**, në programin dhe nën-programin, si vijon: Zyra e Kryetarit (160) nën-programi Zyra e kryetarit (16035) në nën kategorinë (22200) në shumë prej 388.00 €.

VIII

Në kategorinë ekonomike **Shpenzime Kapitale** në shumë prej **84,803.16 €**, në programet dhe nën-programet dhe në projektet, si vijon:

Në programin **Administrata dhe Personeli** (163) nën-programi Administrata (16335) shuma prej 10,000.00 €, në projektin si vijon:

“Mbulimi i parkingut dhe rregullimi i garazhës për automjetet zyrtare” kodi i projektit (45624) në nën kategorinë (31128) në shumë prej 10,000.00 €;

Në programin **Planifikimi urban dhe mjedisi** (660) nën-programi Planifikimi urban dhe inspeksioni (66480) shuma prej **64,803.16 €**, në projektet si vijon:

“Fond për hartimin e projekteve” kodi i projektit (41642) në nën kategorinë (31128) në shumë prej 1,000.00 €; pastaj në nën kategorinë (31230) në shumë prej 3,000.00 €; pastaj në nën kategorinë (31240) në shumë prej 1,000.00 €; pastaj në nën kategorinë (31250) në shumë prej 3,000.00 €;

“Ndërtimi dhe rregullimi i prockës në Lagjen e re” kodi i projektit (41624) në nën kategorinë (32000) në shumë prej 27,954.22 €;

“Mjete të lira për bashkëinvestime” kodi i projektit (41641) në nën kategorinë (31510) në shumë prej 10,000.00 €; pastaj në kategorinë (31701) në shumë prej 8,848.94 €, pastaj në kategorinë (33200) në shumë prej 10,000.00 €;

Në programin **Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale** (730) nën-programi Shërbimet e shëndetësisë primare (75050) shuma prej 10,000.00 €, në projektin si vijon:

“Rregullimi i oborrit dhe bodrumit të QPS-së” kodi i projektit (45663) në nën kategorinë (31120) në shumë prej 10,000.00 €.

IX

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

X

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies sociale, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave - Departamenti i Buxhetit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 30.03.2017

**Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava**





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1777/2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Doracaku Termat e Referencës për Komitetin për Komunitete neni 5.2, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit neni 57. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2017 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2016

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2016.

II

Duke ju referuar nenit I të këtij vendimi pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i punës për vitin 2016 i Komitetit për Komunitete.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komitetit për Komunitete, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 30.03.2017

Kryesuesi i Kuvendit

Qamush Brava

